




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.383/2023
Datë: 28 korrik 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragraf 1, pika 1.2, 1.4, 1.14, neni 25 të Ligjit 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 7, paragrafi 1, pika 1.5, dhe neni 8, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur në çështjen ndaj znj. Ljiljana Stevanoviq, Kryetare në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2023 merr këtë:

V E N D I M

I propozohet Presidentes së Republikës së Kosovës, shkarkimi nga pozita e Kryetares/gjyqtares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, znj. Ljiljana Stevanoviq.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 06 dhjetor 2022, ka pranuar nga kryetari i Gjykatës Supreme z. Enver Peci, kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor për kryetaren e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, znj. Ljiljana Stevanoviq, duke pretenduar se e njëjta ka marrë pjesë në protestën e organizuar nga subjekti politik “Lista Serbe”, me datë 6 nëntor 2022, të mbajtur në pjesën veriore të Mitrovicës. Sipas të gjeturave të Autoritetit Kompetent, subjekti i këtij hetimi disiplinor znj. Ljiljana Stevanoviq, në këtë protestë i është drejtuar pjesëmarrësve me një fjalë rasti, që sipas tij fjalimi i mbajtur nga e njëjta nuk përkon me detyrën e gjyqtarit, i cili fjalim ka qenë pothuajse tërësisht politik, me konstatime të pa qena dhe të drejtuara kundër vet sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, në të cilin me vullnetin e saj është integruar.

Sipas Autoritetit Kompetent pjesëmarrja e kësaj natyre nga ana e kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, është në kundërshtim edhe me nenin 5, paragrafi 2 lidhur me nën paragrafin 2.11, ku përcaktohet se: “Kryen ndonjë funksion, detyrë ose shërbim, merr ndonjë përgjegjësi ose angazhohet me ndonjë aktivitet, kandidon ose zgjidhet në ndonjë funksion apo detyrë që është në kundërshtim me detyrat e gjyqtarit sipas kushtetutës, ligjit për gjykata dhe kodit të etikës profesionale për gjyqtarë” dhe paragrafi 2.16 “anëtarësohet në ndonjë subjekt politik ose ndonjë organizatë tjetër politike, kërkon ose mban ndonjë post politik, kandidon ose zgjidhet në ndonjë post politik, apo angazhohet në ndonjë aktivitet politik” të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas Kushtetutës, Ligjit për Gjykata dhe Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, andaj edhe ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës themelimin e panelit hetimor, me qëllim të hetimit disiplinor, e të cilat veprime bien ndesh me dispozitat ligjore të përcaktuara si më lart.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, ka themeluar panelin hetimor, i cili panel brenda afatit të përcaktuar me ligj ka zhvilluar hetime disiplinore dhe raportin së bashku me provat e bashkangjitura i'a ka dorëzuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Me datë 18 maj 2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën ka prezantuar kryesuesi i panelit hetimor, gjyqtari Faton Ademi dhe subjekti i hetimit, znj. Ljiljana Stevanoviq. Kryesuesi i panelit hetimor në këtë seancë dëgjimore deklaroi se si panel kanë arritur që t'i vërtetojnë faktet se organizimi i tubimit protestues me datë 6 nëntor 2022, ishte politik, deklaramet e pjesëmarrësve, duke përfshirë edhe subjektin e hetimit ishin politike, deklaramet përveç se kanë qenë politike ishin edhe kundër rendit juridik, sepse gjendja e prezantuar në këtë organizim ishte një gjendje jashtë çdo kontesti real. Në këtë tubim protestues ishte prezantuar gjendja jashtë çdo kontesti real, madje, ngjarja përmes së cilës ushtrohej presion për t'u larguar nga institucionet e Republikës së Kosovës, për të gjithë ata që nuk i kanë lëshuar vendet e punës, me pretendim se atyre u janë shkelur të drejtat si komunitet si dhe deklarimi vlerësonte Marrëveshjet e Brukselit dhe në raport me to është pasqyruar një gjendje ndryshe nga ajo që mbretëron në realitet. Më tutje, sipas vlerësimit të panelit deklarimi i subjektit hetues në këtë tubim ishte deklaratë e pastër politike dhe në vetvete bënte dallimin në kuptim të përkatësisë etnike. Në fund të deklaramet, kryesuesi i panelit hetimor i rekomandon Këshillit si organ kompetent që mbi bazën e të gjeturave në këtë raport dhe provave të bashkangjitura këtij raporti, të vlerësoj drejtë dhe t'i shqiptoj masë adekuate e cila do të vlerësohej që është në proporcion me shkeljen e evidentuar.

Subjekti i hetimit deklaroi para Këshillit Gjyqësor të Kosovës se në tubimin protestues të datës 6 nëntor 2022, në të cilin pranon që ka marrë pjesë, e sheh si tubim të tërë komunitetit serb dhe pretendimi se tubimi ka qenë politik sipas saj është më shumë ngjyrosje dhe në të njëjtën kohë e mohon që ndonjëherë ka qenë pjesë e ndonjë subjekti politik. Më tutje, subjekti i hetimit rreth deklaramet se pjesëmarrja në tubim ka qenë e vullnetshme apo e imponuar, deklaroi se presioni në ambient ka qenë i mjaftueshëm. Subjekti i hetimit gjithashtu deklaroi se ajo ka edhe një sanksion disiplinor të shqiptuar me herët nga ana e Këshillit, për pretendimet e natyrës së njëjtë dhe kërkoi nga Këshilli që të veprojë bazuar në rregullat dhe ligjet që janë në fuqi.

Për të vërtetuar këtë çështje disiplinore, Këshilli i administroi këto prova: Kërkesën e fillimit të hetimeve disiplinore të pranuar prej Autoritetit Kompetent të datës 6 dhjetor 2022; Vendimin e Këshillit të datës 14 dhjetor 2022 për themelimin e panelit hetimor; Procesverbalin e datës 13 shkurt 2023; shënimin zyrtar të datës 13 shkurt 2023; Procesverbalin e datës 2 mars 2023; dhe CD-në.

Procesverbali i datës 13 shkurt 2023, përmban deklaratën e subjektit hetimor të dhënë te paneli hetimor e cila nuk ka kontestuar pjesëmarrjen në protestën e Listës Serbe si dhe fjalimin e saj drejtuar protestuesve si: "Populli im, vëllezër dhe motra, rroftë Serbia, atdheu ynë, rroftë presidenti ynë Aleksandër Vuçiq, presim ndihmën prej tij". Më tutje e njëjta ka vazhduar me frazat "Presidenti ynë Aleksandër Vuçiq, nuk e len kurr këtë komb".

Shënimin zyrtar të datës 13 shkurt 2023, përmban ftesën drejtuar subjektit të hetimit për pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të panelit hetimor, si dhe arsyen lidhur me kërkesën e saj për shtyerjen e seancës dëgjimore te paneli.

Procesverbali i datës 2 mars 2023, deklarimi i subjektit te paneli hetimor sa i përket pretendimeve të Autoriteti Kompetent për shkelje disiplinore.

Audioincizimi/CD: Përmban fjalimin e subjektit të hetimit drejtuar protestuesve si: “të dashur qytetar, të dashur miq, njerëzit e mi, vëllezërit dhe motrat e mia, sot dua të ju informojë se të gjithë ne gjyqtar dhe prokuror të sistemit gjyqësor jemi larguar nga sistemi gjyqësor i Kosovës, duke pasur parasysh se marrëveshja e Brukselit është shembull aq shumë sa që është bërë një shkronjë e vdekur”, më tutje në përmbyllje të fjalimit ka thënë “rroftë Serbia, atdheu ynë, rroftë Presidenti Aleksandër Vuçiq, presim ndihmën prej tij, dhe nëse na shohin të gjithëve sot do ta kuptojnë apelin dhe ndihmën tonë për të qëndruar së bashku në drejtësi dhe barazi për të gjithë qytetarët. Po ashtu gjatë incizimit vërehen flamuj dhe logo të shtetit Serb dhe subjekti politik “Lista Serbe”.

Këshilli, pas shqyrtimit dhe analizimit të kësaj çështje, duke u bazuar në provat e lëndës me të cilat vërtetohet se znj. Ljiljana Stevanović ka marrë pjesë në protestën e organizuar nga subjekti politik “Lista Serbe”, me datë 6 nëntor 2022, protestë kjo e cila është paraqitur në të gjitha mediat e Kosovës, ku znj. Ljiljana Stevanović, ka prezantuar duke mbajtur fjalim rasti me përmbajtje të pastër politike, e cila është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore dhe përben shkelje të neni 5, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.11 dhe 2.16 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe me nenin 2. paragrafi 2.2.3 të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar.

Në nenin 5, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.11 dhe 2.16 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është parashikuar se shkelje e detyrave të gjyqtarit sipas këtij Ligji, përfshinë veprimet e mëposhtme, kur në mes tjerash janë përcaktuar edhe rastet kur gjyqtari: *“Kryen ndonjë funksion, detyrë ose shërbim, merr ndonjë përgjegjësi ose angazhohet me ndonjë aktivitet, kandidon ose zgjidhet në ndonjë funksion apo detyrë që është në kundërshtim me detyrat e gjyqtarit sipas kushtetutës, ligjit për gjykata dhe kodit të etikës profesionale për gjyqtarë”* ose *“anëtarësohet në ndonjë subjekt politik ose ndonjë organizatë tjetër politike, kërkon ose mban ndonjë post politik, kandidon ose zgjidhet në ndonjë post politik, apo angazhohet në ndonjë aktivitet politik”*.

Ndërsa, në nenin 2. paragrafi 2.2.3, pika b) të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar është përcaktuar se *“gjyqtari nuk mund të marrë pjesë në tubime apo manifestime politike”*.

Veprimet e lartëcekura të subjektit të hetimit janë në kundërshtim me rregullat e lartëcekura të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar, dhe bien ndesh edhe me një mori parimesh të cilat janë të akceptuara në shumë dokumente ndërkombëtare, ku është parashikuar pavarësia dhe paanësia e gjyqtarëve në raport me çdo veprim që mund të përfaqëjë një mesazh që ka karakter politik dhe të marrë pjesë në veprimtari që organizohen nga subjektet politike përkatëse.

Bazuar në këto rregulla dhe parime, pjesëmarrja e subjektit të hetimit në aktivitete politike të organizuar nga “Lista Serbe”, konsiderohet mosrespektim i rëndë i detyrave të gjyqtarit dhe cënon rëndë besimin e publikut në paanësinë dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe gjyqtarit përkatësisht subjektit të hetimit në përgjithësi.

Sipas vlerësimit të Këshillit, mos ndërmarrja e asnjë veprimi nga subjekti i hetimit disiplinor për ta zbutur dëmin e shkaktuar si rezultat i cenimit të besueshmërisë së publikut në gjyqësor me

deklarimin e mbajtur në protestën e datë 6 nëntor 2022, është përquar mesazh dekurajues për të tjerët.

Si rrethanë rënduese Këshilli mori edhe atë se subjekti i këtij hetimi znj.Ljiljana Stevanoviq, është recidiviste në procedurën disiplinore, pothuasje për shkelje të përaferta që i referohen pjesëmarrjes në takim me persona politik, për të cilën Këshilli me datë 28 prill 2022, i ka shqiptuar sanksion disiplinor ulje e pages në lartësi prej tridhjetë për qind (30%), në kohëzgjatje për katër (4) muaj, të përcaktuar në dispozitën e nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 të të njejtit ligj, nënkupton se përgjegjësia është edhe më e madhe.

Andaj, Këshilli në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28 korrik 2023, duke u bazuar edhe në të lartëcekurat, në mënyrë unanime vendosi që t'i propozojë Presidentes së Republikës së Kosovës shkarkimin e znj.Ljiljana Stevanoviq, nga ushtrimi i funksionit të gjyqtares/kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.383/2023, datë 28 korrik 2023



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtëpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- z. Bekim Veliqi, u.d kryetar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë
- znj.Ljiljana Stevanovic, kryetare e Gjykatës Themelore në Mitrovicë,